

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aleksandar Vuçiç jep dorëheqjen si president i Serbisë
ADRESA	https://lapsi.al/aleksandar-vucic-jep-doreheqjen-si-president-i-serbise-i1094595
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:58:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:57:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c71a82d5ad6752314065d7dd65e437bed1e8b0afc52d2f4b9ccb5d092da077bc
TEKSTI	1accc90be18f9c3408384a0fd91bb866eb080c9ea0e6c2c33862067afbe9427c
PAMJA	411d0718c266692b6105801c8cfd378b67a336c10a0b55284ab0a296fec0ff34

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7aa23053af44da5df206d42c4bb7d64607ff87d05f253b02b899868f32e81a99
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7aa23053af44da5df206d42c4bb7d64607ff87d05f253b02b899868f32e81a99

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aleksandar Vučić jep dorëheqjen si president i Serbisë



LAPSI.AL • 27 SEPTEMBER 2026



Presidenti i deritanishëm i Serbisë, Aleksandar Vučić, dha dorëheqjen nga posti i të parit të shtetit serb, në mbrëmjen e 27 shtatorit.

Ai dha dorëheqjen të dielën për të marrë pjesë në garën për postin e kryeministrit si kandidat i partisë së tij, Partisë Përparimtare Serbe (SNS).

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare ai i kishte shpallur më herët për 25 tetor.

Vučić u tërhoq nga posti i kreut të shtetit serb tetë muaj para përfundimit të mandatit të tij presidencial, i cili sipas ligjit do të përfundonte në maj të vitit 2027.

Vučić është zgjedhur dy herë president i Serbisë.

Meqë Kushtetuta e Serbisë nuk lejon një mandat të tretë, ai nuk do të mund të kandidonte sërish.

Pas dorëheqjes së Vučićit, Serbia do të ketë ushtrues detyre të presidentit të shtetit.

Këtë detyrë do ta marrë Ana Bërnabiq, kryetare e deritanishme e Kuvendit të Serbisë, i cili u shpërbë pas shpalljes së zgjedhjeve parlamentare.

Ajo mund të qëndrojë në këtë detyrë për më së shumti tre muaj.

Vučić tha në një adresim për publikun se rundi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të mbahet deri në fund të dhjetorit.

Përveç kësaj, ai tha se kishte marrë vendim për amnisti dhe falje për 49 persona.

“Prej tyre, 23 persona janë të lidhur me të gjitha këto ngjarje të tmerrshme nëpër të cilat kemi kaluar gjatë një viti e gjysmë të fundit”, tha Vučić.

ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsiu



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

18°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:08

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë

22:06



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasia direkt pas kthimit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Kur do të mbahen zgjedhjet për presidentin ose presidenten e re të Serbisë?

Dorëheqja e Vuçiqit do të thotë se qytetarët e Serbisë, pas zgjedhjeve parlamentare të 25 tetorit, do të shkojnë sërish në qendrat e votimit.

Sipas ligjit, zgjedhjet presidenciale shpallen “në mënyrë që votimi të mbahet jo më vonë se tre muaj nga dita kur presidenti i përfundon mandati”.

Gjithashtu, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e votimit nuk mund të kalojnë më pak se 30 dhe më shumë se 60 ditë.

Kjo do të thotë se zgjedhjet presidenciale do të mbahen më së voni në fund të dhjetorit, ndërsa më së hershmi në fillim të nëntorit të këtij viti.

Akuzat për fushatë nga funksionarët

Vuçiq dhe Partia e tij Përparimtare Serbe janë boshti i pushtetit në Serbi që nga viti 2012.

Në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, Vuçiq njoftoi se dëshiron të rikthehet në postin e kryeministrit, detyrë të cilën e ka mbajtur për dy mandate.

Në fushatën për këto zgjedhje ai hyri nga pozita e presidentit të shtetit – pranoi të jetë bartës i listës zgjedhore që SNS-ja, së bashku me partnerët e saj të koalicionit, e dorëzoi dy javë para dorëheqjes së Vuçiqit.

Debatin nëse është në kundërshtim me ligjin që presidenti i Serbisë të jetë njëkohësisht edhe kandidat në zgjedhjet parlamentare e hapi në publik organizata joqeveritare Byroja për Kërkime Shoqërore (BIRODI).

Ajo kërkoi nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit që të shprehej lidhur me këtë çështje.

Megjithatë, kjo kërkesë mbeti pa përgjigje.

BIRODI e paraqiti më 15 shtator edhe një ankesë ndaj pjesëmarrjes së Vuçiqit në fushatë pranë Komisionit Republikani të Zgjedhjeve (RIK), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor.

Një ditë më vonë, RIK-u e hodhi poshtë ankesën si “të pabazuar”.

Edhe para fillimit të aktiviteteve parazgjedhore, opozita dhe vëzhguesit e zgjedhjeve e kishin kritikuar disa herë presidentin se po e keqpërdorte funksionin shtetëror për promovimin e partisë së tij.

Përparimtarët i hodhën poshtë këto akuza, duke thënë se me partinë merren “jashtë orarit të punës”.

Për problemin e fushatës nga funksionarët në Serbi, përkatësisht përdorimin e pozitave shtetërore për promovimin e partisë gjatë procesit zgjedhor, prej vitesh kanë tërhequr vërejtjen vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë. /Marrë nga **Radio Evropa e Lirë**



Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti, ka kaq shumë për të thënë



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasit direkt pas kthimit



“Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri”



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë \$ në Shqipëri

Të keshilluara



PD i përgjigjet fjalimit të Ramës: Ti je kryehajduti i shqiptarëve

Pas fjalimit të kryeministrit Edi Rama në aeroportin e Rinasit ka reaguar Partia Demokratike me anë të PD-së, Belind Këlliç...



U martua me një ruse për të humbur gjurmët/ Si u pikas Salvatore Aliu

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku...



Motori u përplas me shtyllën në Cërrik, humb jetën 21-vjeçari, plagoset një i mitur



Çfarë e shkaktoi shpërthimin në Athinë që u mori jetën 3 shqiptarëve

Kanë mbërritur në Athinë të afërmit e viktimave që humbën jetën në shpërthimin dhe shembjen e ndër...



“200 metrat” që liruan Gotovinën dhe mësimi për katërshen e UÇK-së

Pas dënimit për krime lufte të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli,...



“Jeni rrezik për sigurinë kombëtare”/ Azgan Haklaj dhe Ferdinand Samarxhi ndalohen në kufi me Maqedoninë e Veriut

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare tSe...





Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori



Zjarri përfshin një hotel pranë pedonales në Shkodër

Një hotel pranë pedonales së qytetit të Shkodrës është përfshirë nga flakët e zjarrit. Tre mjete zjarrfikëse...



Protesta sot mbush katër muaj, plot 120 ditë

Protesta qytetare kundër qeverisë hyn sot në ditën e 120-të, ndërsa aktivistë dhe qytetarë pritet të mbledhen së...



Rama: Drejtësinë e re nuk e solli as Amerika, as Europa, e solla unë

Kryeministri Edi Rama ka folur për reformën në drejtësi dhe pavarësinë e institucioneve të drejtësisë, duke ia dhënë...

Me sytë katër



19:19

VIDEO/ Qëllohet me vezë kryeministri hungarez Péter Magyar

Një incident ka ndërprerë fjalimin e kryeministrit hungarez Péter Magyar gjatë një aktiviteti elektorale në qytetin e Szoln...



VIDEO/ Theu derën e supermarketit në Vlorë dhe mori kasën, por u arrestua

17:23



"Më shau, e shava"/ Shefi i komisarit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

21:35



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44

SPORT

→ Të tjerë artikuj





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.